



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 5, 6, 7 dhe 13 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021), nenit 7 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në ZKA; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit Nr. 1396 të datës 25.07.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Drejtor i Përgjithshëm
Numri i referencës:	DP/ZKA/16-07/22
Grada:	ZKA-C1
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me mandat Pesë (5) vjet

Qëllimi i Pozitës:

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të shërbimeve të përgjithshme administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Është përgjegjës për mbështetjen administrative dhe menaxhimin e administratës së përgjithshme të Zyrës kombëtare të auditimit, duke përfshirë edhe çështjet financiare, logjistike, teknologjisë informative dhe prokurimit.
- Bën përgatitjen e planeve të punës sipas Planit vjetor të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe mbikëqyrë zbatimin e tij me qëllim të përmbushjes së mandatit dhe funksionit të Zyrës kombëtare të auditimit.
- Në bashkëpunim me njësitë tjera organizative, duke analizuar dhe vlerësuar proceset e punës brenda Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe në pajtim me Auditorin e Përgjithshëm, vendos për ndryshimet dhe përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
- Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, përfaqëson Zyrën Kombëtare të Auditimit, në fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mandatin dhe funksionin e tij.
- Ofron udhëzime dhe këshilla të sakta dhe të paanshme profesionale për Auditorin e Përgjithshëm, në fushat përkatëse.
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë fakulteti në ekonomi, drejtësi ose administratë publike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike, drejtësisë ose administratës publike; dhe
- Katër (4) vite përvojë pune menaxheriale.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- Dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 26.07.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 10.08.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen/shkarkohen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00. Formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.